



Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.739/19

Datë: 30.09.2019

Drejtoria për Arsim në Komunën e Istogut duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, UA-MASHT, nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, si dhe UA-MASHT, nr.02/2017 Për Vlefshmërinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shpall këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës për mësimdhënës/e,

Në SHFMU "Bajram Curri" Istog

1. Një mësimdhënës/e për Kimi zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi mjeksor.

Në SHFMU "Martin Camaj" Gurrakoc

1. Një mësimdhënës/e për Tik zëvendësim, derisa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë.

Në SHFMU "Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe" Uçë

1. Një mësimdhënës/e për Tik norm jo e plotë kohëzgjatja e kontratës vetëm deri me 31.08.2020.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Certifikata e lindjes, jo më e vjetër se 6 muaj,
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës, e vërtetuar, jo me e vjetër se gjashtë muaj, çdo certifikatë me e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet t' i kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime, jo më e vjetër se 6 muaj
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, MASHT, Nr.10/2018 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 30.09.2019 deri me datën 14.10.2019.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhës dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës, po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje. Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit, ndërsa i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet.

Gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit(kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret, bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi, kurse intervistës do t'i nënshtrohen vetëm kandidatët - kandidatët, të cilët- të cilat arrin të kenë me shumë se 50 për qind të kalueshmërisë se testit më shkrim.

Drejtori i DKA-së
Hajrush Shoshi

